



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 135 prot.

Kamëz, më 20. 11. 2023

V E N D I M

Nr. 92, datë 20. 11 2023

MBI

MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA ADMINISTRATORET SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.11.2023, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.66 Datë 14.11.2023, Mbështetur në Ligjin 57. Date 18.07.2019 "Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 21, VKM – në nr.956, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore" Kreu IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%" të ndryshuar kreu IV, pika 3, Vendim 868, datë 29.12.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.597 date 04.09.2019 dhe në VKB nr. 04 datë 23.01.2023 "Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit". **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së muajit **Tetor 2023**, prej **71 familje** që janë rekomanduar nga administratoret shoqëror për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike.
Fondi për këto familje është **400,355 (katërqind mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.**
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij vendimi paraqitet në relacionin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

